

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitet 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-T

Data: 13 shkurt 2012

Originali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE II

Para: Gjykatësit Bakone Justice Moloto, Kryegjykatës
Gjykatësit Burton Hall
Gjykatësit Guy Delvoie

Sekretar: Z. John Hocking

Vendim: 13 shkurt 2012

PROKURORI

kundër

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

PUBLIK

**VENDIM MBI NJOFTIMIN PËR PËRMBUSHJEN E VENDIMIT TË
RREGULLËS 92BIS**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Paul Rogers

Avokatëve të të Akuzuarve

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen M. Rohan për Idriz Balajn
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

KJO DHOMË GJYQËSORE (“Dhoma”) e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej vitit 1991 (“Tribunali”) ka marrë “Njoftim për përmbushjen e Vendimit të Rregullës 92bis” (“Njoftimi”), paraqitur publikisht prej Zyrës së Prokurorit (“Prokuroria”) së bashku me shtojcat publike A-D më 21 dhjetor 2011 (“Njoftim”).

I. HISTORIA PROCEDURALE

1. Më 22 korrik 2011, kjo Dhomë nxori “Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin e transkripteve të dëshmive në vend të dëshmive gojore sipas Rregullës 92bis(“Vendimi i Rregullës 92bis”), në të cilin, midis të tjerave, i pranoi si provë transkriptet e propozuara të dëshmive të Branimir Aleksandriqit dhe Dushan Dunjiqit në përputhje me Rregullën 92bis të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit (“Rregullorja”), me kusht që Prokuroria të redaktonte nga transkriptet e dëshmive të tyre çfarëdo referencash për materialet të cilat në atë fazë nuk ishin propozuar për pranim.¹ Dhoma gjithashtu urdhëroi pranimin si provë sipas Rregullës 92bis të transkriptit të propozuar të dëshmisë së Stanisha Radosheviqit, me kusht redaktimin nga transkripti të referencave për pamjen e një embleme të UÇK-së, në harta që iu treguan dëshmitarit dhe u shënuan prej tij dhe në një fotografi, apo ndryshe, me pëlqimin e Mbrojtjes, paraqitjen e këtyre dokumenteve që mungojnë si provë.²

2. Në Vendimin e Rregullës 92bis, Dhoma nuk i pranoi si provë dy paketa ditarësh/fletoresh dyvëllimëshe që Prokuroria i paraqiti për pranim përmes dëshmisë së Marijana Angjelkoviqit, për arsye se në rrethanat ekzistuese nuk mund të konkludonte mbi rëndësinë dhe vlerën provuese të dokumenteve të propozuara.³ Dhoma udhëzoi Prokurorinë se mund të paraqiste si provë faqe konkrete të këtyre dokumenteve pasi së pari të ketë identifikuar ndryshimet midis dy paketave të dokumenteve, për cilat faqe të transkriptit të dëshmisë së mëparshme të Marijana Angjelkoviqit e ka fjalën, të cilat

¹ Vendimi i Rregullës 92bis, para. 36, Vendim (2) a-b.

² Vendimi i Rregullës 92bis, para. 36, Vendim (2) a-b.

³ Vendimi i Rregullës 92bis, para. 44.

kërkon të pranohen, dhe të ofrojë përkthim zyrtar në anglisht të dokumenteve të cilat kërkon të pranohen.⁴

3. Më 21 dhjetor 2011, Prokuroria paraqiti Njoftimin ku e njoftoi Dhomën për përmbushjen e Vendimit të Dhomës të Rregullës 92bis në lidhje me dëshmitarët Branimir Aleksandriq, Dushan Dunjiq dhe Marijana Angjelkoviq.⁵ Rrjedhimisht, ajo kërkon pranimin e versioneve të redaktuara të transkripteve të dëshmive të Branimir Aleksandriqit dhe Dushan Dunjiqit dhe të dy paketave të pjesëve të ditarit/fletores dyvëllimëshe të Marijana Angjelkoviqit.⁶

4. Në lidhje me këtë, Prokuroria njofton Dhomën se versioni i pasaktë i njërit prej përkthimeve të fletores/ditarit të Marijana Angjelkoviqit – dokumenti i Rregullës 65ter numër 00322 - është vendosur gabimisht në dokumentacionin gjyqësor elektronik.⁷ Për këtë arsye, ajo kërkon leje për zëvendësimin e përkthimit në anglisht të dokumentit të Rregullës 65ter numër 00322 me dokumentin numër ID U003-0254-ER-2.⁸

II. PARASHTRIME

5. Prokuroria parashtron se ka vendosur në dokumentacionin gjyqësor elektronik versionet e redaktuara të transkripteve të dëshmive të Branimir Aleksandriqit dhe Dushan Dunjiqit në çështjen IT-04-84-T dhe kërkon zëvendësimin e tyre.⁹ Prokuroria e ka të qartë se këto versione kanë të bëjnë me materiale që nuk janë pjesë e dokumentacionit gjyqësor të rigjykimit; për këtë arsye Prokuroria nuk i ka redaktuar referencat për materialet e diskutuara në dëshmitë e Aleksandriqit dhe Dunjiqit të pranura si provë në këtë çështje përmes dëshmitarëve të tjerë.¹⁰ Në Shtojcën A të Njoftimit, Prokuroria ka paraqitur një listë të këtyre materialeve provën materiale apo me numrat e Rregullës 65ter të përdorur në procesin e parë *Haradinaj* dhe numrat përkatës të provave materiale

⁴ Vendimi i Rregullës 92bis, para. 44.

⁵ Njoftimi, para. 1.

⁶ Njoftimi, para. 1-3.

⁷ Njoftimi, para. 4, 20.

⁸ Njoftimi, para. 4, 20.

⁹ Njoftimi, para. 2, 7

¹⁰ Njoftimi, para. 5.

apo të Rregullës 65ter në rigjykim.¹¹ Prokuroria kërkon leje për zëvendësimin në dokumentacionin elektronik të gjykatës të dokumenteve në vijim: dokumentin e Rregullës 65ter numër 04054 me dokumentin ID TR00-4054-RED;¹² dokumentin e Rregullës 65ter numër 04056 me dokumentin ID TR00-4056-RED,¹³ dhe dokumentin e Rregullës 65ter numër 04057 me dokumentin ID TR00-4057-RED.¹⁴

6. Prokuroria më tej parashtroi se ka përmbushur Vendimin e Dhomës të Rregullës 92bis në lidhje me Marijana Angjelkoviqin.¹⁵ Rrjedhimisht, ajo kërkon që pjesët e ditarit/fletores së Marijana Angjelkoviqit – dokumentet e Rregullës 65ter numër 00321 dhe 00322, të paraqitura në Shtojcën B të Njoftimit – dhe dokumentet e Rregullës 65ter numër 00003 dhe 00004 të paraqitura në Shtojcën D të Njoftimit, të pranohen si prova materiale publike.¹⁶

7. Prokuroria shpjegon mospërputhjen midis dokumenteve të Rregullës 65ter numër 000321 dhe 000322 dhe dokumenteve të Rregullës 65ter numër 00003 dhe 00004¹⁷ si më poshtë: gjatë dëshmisë së saj në procesin e parë *Haradinaj* më 6 mars 2007, Marijana Angjelkoviqi komentoi dokumentet e shënuara për identifikim me P1 dhe P2 në atë proces.¹⁸ Prokuroria argumenton se për shkak të mospërputhjes midis referencave të faqeve të dokumentit origjinal me përkthimin përkatës të pjesëve të përzgjedhura, më 7 mars 2007, në procesin e parë *Haradinaj* Prokuroria paraqiti dy dokumente të reja që u shënuan për identifikim si P3 dhe P4 dhe u përdorën gjatë pyetjeve të palës kundërshtare.¹⁹ Më 8 mars 2007, Dhoma Gjyqësore në procesin e parë *Haradinaj* shtyu vendimin e saj për pranimin e ditarit të Angjelkoviqit deri sa Prokuroria të bënte

¹¹ Njoftimi, para. 6.

¹² Njoftimi, para. 7; Transkripti i dëshmisë së Branimir Aleksandriqit në çështjen IT-04-84-T.

¹³ Njoftimi, para. 7; Transkripti publik/i redaktuar i dëshmisë së Dushan Dunjiqit në çështjen IT-04-84-T.

¹⁴ Njoftimi, para. 7; Transkripti i dëshmisë së Dushan Dunjiqit në çështjen IT-04-84-T.

¹⁵ Njoftimi, para. 1.

¹⁶ Njoftimi, para. 3.

¹⁷ Këto dokumente korrespondojnë me provat e mëparshme materiale P321, P322, P3 dhe P4 nga procesi i parë *Haradinaj*.

¹⁸ *Shih* Lënda IT-04-84-T, T. 463-553 (6 mars 2007), këto dokumente identifikohen si dokumente të Rregullës 65ter numër 00001 dhe 00002 nga rigjykimi *Haradinaj*.

¹⁹ Njoftimi, para. 11; i referohet Lëndës IT-04-84-T, T. 570-572; 628; 637 (7 mars 2007). Këto dokumente identifikohen si dokumente të Rregullës 65ter numër 00003 dhe 00004 nga rigjykimi *Haradinaj*.

verifikimin dhe riorganizimin e dy vëllimeve të dokumentit.²⁰ Më 22 maj 2007, versionet e rirenditura të ditarit/fletores dyvëllimëshe të pranuar nga palët u pranuan si prova në procesin e parë *Haradinaj* me numrat P321 dhe P322.²¹ Dokumentet e shënuara si dokumente të Rregullës 65ter numër 00003 dhe 00004 në këtë rigjykim, më 22 maj 2007 u pranuan si prova edhe në procesin e parë *Haradinaj*, me numrat P3 dhe P4.²² Në procesin e parë *Haradinaj*, dokumentet e shënuara për identifikim me P1 dhe P2 u hoqën dhe u zëvendësuan me provat P3 dhe P4.²³

8. Prokuroria argumenton se në Shtojcën B të Njoftimit ka paraqitur pjesët e dokumenteve të rregullës 65ter numër 00321 dhe 00322 mbi të cilat ajo mbështetet, gjegjësisht pjesët që iu treguan dëshmitares prej palëve gjatë dëshmisë së saj dyditëshe, si dhe pjesë të tjera që Prokuroria i konsideron të rëndësishme.²⁴

9. Prokuroria më tej parashtrohet se në Shtojcën C të Njoftimit ka paraqitur pjesët e dokumenteve të Rregullës 65ter numër 00001 dhe 00002 që iu treguan dëshmitares gjatë ditës së parë të dëshmisë së saj në procesin e parë *Haradinaj*.²⁵ Në Shtojcën C të Njoftimit janë paraqitur edhe faqet përkatëse nga dokumentet e Rregullës 65ter numër 000321 dhe 000322.²⁶ Prokuroria shpjegon se ndryshimi midis përkthimeve në anglisht të pjesëve përkatëse të dokumenteve të rregullës 65ter numër 00001 dhe 00002 dhe të dokumenteve të Rregullës 65ter numër 00321 dhe 00322 qëndron në faktin se në dokumentet e Rregullës 65ter numër 00001 dhe 00002 nuk përmenden numrat ERN, kurse teksti në thelb është i njëjtë.²⁷

10. Prokuroria gjithashtu parashtrohet se ka marrë përkthimet zyrtare të Shërbimit të Përkthimit të Tribunalit ("CLSS") të pjesëve përkatëse të dokumenteve të Rregullës 65ter numër 00321 dhe 00322, por se përkthimet e marra ndryshojnë në masë të

²⁰ Njoftimi, para. 12, i referohet Lëndës IT-04-84-T, T. 684 (8 mars 2007).

²¹ Njoftimi, para. 12, i referohet Lëndës IT-04-84-T, T. 4527-4531 (22 maj 2007).

²² Njoftimi, para. 12, i referohet Lëndës IT-04-84-T, T. 4531 (22 maj 2007).

²³ Njoftimi, para. 12, i referohet Lëndës IT-04-84-T, T. 10489-10490 (8 nëntor 2007).

²⁴ Njoftimi, para. 16.

²⁵ Njoftimi, para. 17.

²⁶ Njoftimi, para. 17.

²⁷ Njoftimi, para. 17.

konsiderueshme prej atyre që komentoi dëshmitarja gjatë dëshmisë së saj.²⁸ Prokuroria parashtron se përkthimet e CLSS-së i ka vendosur në dokumentacionin gjyqësor elektronik si dokumente të Rregullës 65ter numër 00321.1 dhe 00322.1, në rast se Dhoma do t'a gjykojë të nevojshme pranimin e tyre si prova, por vetë Prokuroria nuk i paraqet ato për pranim si provë.²⁹

11. Prokuroria njofton se në Shtojcën D të Njoftimit ka paraqitur pjesët e dokumenteve të Rregullës 65ter numër 00003 dhe 00004 që iu treguan dëshmitares gjatë pyetjeve të palës kundërshtare në ditën e dytë të dëshmisë së saj.³⁰

12. Prokuroria njofton se në dokumentacionin gjyqësor elektronik është vendosur gabimisht versioni i pasaktë i përkthimit të dokumentit të Rregullës 65ter numër 00322 dhe kërkon leje që të zëvendësojë përkthimin në anglisht të dokumentit të Rregullës 65ter numër 00322 me dokumentin ID U003-0254-ER-2.³¹

13. Prokuroria njofton se për të pasur dokumentacion të plotë gjyqësor, në dokumentacionin elektronik të gjykatës ka vendosur provat e mëparshme P1 dhe P2 si dokumente të Rregullës 65ter numër 00001 dhe 00002, në rast se Dhoma do t'a gjykojë të nevojshme pranimin e tyre si prova, por vetë Prokuroria nuk i paraqet ato për pranim si provë.³²

14. Asnjë prej të Akuzuarve nuk paraqiti përgjigje ndaj Njoftimit të Prokurorisë.

III. DISKUTIM

15. Sipas Rregullës 89(C) të Rregullores së Procedurës dhe Provave, “një Dhomë mund të pranojë çfarëdo prove përkatëse të cilën e gjykon me vlerë provuese.”³³

²⁸ Njoftimi, para. 18.

²⁹ Njoftimi, para. 18.

³⁰ Njoftimi, para. 19.

³¹ Njoftimi, para. 20.

³² Njoftimi, para.15.

³³ Rregulla 89(C) e Rregullores së Procedurës dhe Provave

16. Dhoma është e bindur se me heqjen e redaktimeve të propozuara të transkripteve të dëshmive dhe deklaratave me shkrim të Branimir Aleksandriqit dhe Dushan Dunjiqit, dhe të referencave për fotografitë, aktautopsitë, videomaterialet dhe transkriptet nga gjykime të tjera në Tribunal (të cilat nuk propozohen për pranim si provë në këtë fazë), dokumentet e paraqitura përmbushin udhëzimin e Dhomës për heqjen e referencave për materiale të tilla.

17. Dhoma rishikoi pjesët e ditarit/fletores së Marijana Angjelkoviqit dhe është e bindur se dokumentet e propozuara janë të rëndësishme dhe me vlerë provuese për çështjet në këtë proces. Prokurori kërkoi të paraqesë si provë më shumë versione të të njëjtit tekst apo teksti të ngjashëm. Dhoma vëren se Prokuroria ka paraqitur dokumentet e Rregullës 65ter numër 00321 dhe 00322 si versione të ditarit/fletores dyvëllimëshe mbi të cilat ajo mbështetet,³⁴ dhe se më tej ka paraqitur edhe dokumentet e Rregullës 65ter numër 00003 dhe 00004 për të treguar dokumentin mbi të cilin u mbështet dëshmitarja gjatë ditës së dytë të dëshmisë së saj. Në përputhje me udhëzimet e Dhomës, Prokuroria paraqiti përkthimet zyrtare të CLSS-së të pjesëve që për mendimin e saj lidhen me dokumentet e Rregullës 65ter numër 00321 dhe 00322, të cilat janë vendosur në dokumentacionin gjyqësor elektronik si dokumente të rregullës 65ter numër 00321.1 dhe 00322.1. Megjithëse përkthimet e reja në anglisht dallojnë nga përkthimet që i janë bashkëlidhur dokumenteve të Rregullës 65ter numër 00321 dhe 00322, përkthimet e reja nuk iu treguan dëshmitares dhe ajo nuk u mbështet në to gjatë dëshmisë së saj. Duke mos parë ndonjë përfitim më të madh nga përdorimi i përkthimeve të dokumenteve të Rregullës 65ter numër 00321 dhe 00322 krahasuar me përkthimet e dokumenteve të Rregullës 65ter numër 00321.1 dhe 00322.1, dhe duke u dhënë përparësi përkthimeve zyrtare të këtyre dokumenteve, Dhoma gjykon se dokumentet e Rregullës 65ter numër 00321.1 dhe 00322.1 janë përkthimi mbi të cilin do të mbështet Dhoma gjatë rishikimit të transkriptit.

18. Për sa u përket dokumenteve të Rregullës 65ter numër 00003 dhe 00004, historia procedurale vë qartë në dukje se pjesët përkatëse të këtyre dokumenteve janë të

³⁴ Njoftimi, para. 14.

nevojshme për Dhomën në mënyrë që ajo të mund të kuptojë transkriptin dhe dëshminë e Marijana Angjelkoviqit.

19. Për të njëjtat arsye si në rastin e dokumenteve të Rregullës 65*ter* numër 00003 dhe 00004, Dhoma i pranon pjesët përkatëse të dokumenteve të Rregullës 65*ter* numër 00001 dhe 00002.

IV. VENDIM

Për arsyet e lartpërmendura dhe në përputhje me Rregullat 54 dhe 89(C) të Rregullores, Dhoma

- (1) **LEJON** Prokurorinë që në dokumentacionin elektronik të gjykatës të zëvendësojë dokumentet në vijim:
 - a. dokumentin e Rregullës 65*ter* numër 04054 me dokumentin ID TR00-4054-RED;
 - b. dokumentin e Rregullës 65*ter* numër 04056 me dokumentin ID TR00-4056-RED;
 - c. dokumentin e Rregullës 65*ter* numër 04057 me dokumentin ID TR00-4057-RED;
- (2) **URDHËRON** pranimin e dokumentit ID TR00-4057-RED të mbyllur me vulë;
- (3) **URDHËRON** pranimin si provë të pjesëve të dokumenteve të Rregullës 65*ter* numër 00001 dhe 00002 të paraqitura në Shtojcën C të Njoftimit, dhe të pjesëve të dokumenteve të Rregullës 65*ter* numër 00003 dhe 00004 të paraqitura në Shtojcën D të Njoftimit;
- (4) **REFUZON** kërkesën e Prokurorisë për pranimin si provë të dokumenteve të Rregullës 65*ter* numër 00321 dhe 00322;

- (5) **URDHËRON** pranimin si provë të dokumenteve të Rregullës 65*ter* numër 00321.1 dhe 00322.1;
- (6) **UDHËZON** Sekretarin që t'u caktojë numrin e provës dokumenteve të pranuar në përputhje me këtë Vendim dhe me Vendimin e Dhomës të Rregullës 92*bis* në lidhje me dëshmitarin për të cilin/cilën Prokuroria dorëzoi njoftim për përmbushje.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Bakone Justice Moloto
Kryegjykatës

Sot, më datën 13 shkurt 2012.
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]